

Në bazë të nenit 28 të Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës dhe njësave akademike të Universitetit të Tetovës, Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës më 28.12.2016 solli këtë:

VENDIM

për mënyrën e votimit gjatë mbajtjes së zgjedhjeve dhe vendin e qendrave të votimit në njësitë akademike të Universitetit të Tetovës

Neni 1

Fletëvotimi për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor është me format A5. Fletëvotimi do të përmbajë logon e Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, emrin dhe mbiemrin e kandidatëve dhe vulën e Parlamentit Studentor.

Neni 2

Për Kryetar të Parlamentit Studentor votohet duke rrethuar numrin rendor përpara emrit të kandidatit.

Neni 3

Për Kryetar të Parlamentit Studentor do të votohet në gjithsej gjashtë qendra të votimit, të vendosura në njësitë akademike të Universitetit të Tetovës, edhe atë:

1. Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik,
2. Fakulteti Filologjik dhe Fakulteti Filozofik;
3. Fakulteti i Kulturës Fizike, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Fakulteti i Shkencave të Zbatuara dhe Fakulteti i Arteve;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
5. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore;
6. Fakulteti i Administratës së Biznesit;

Neni 4

Ky Vendim shpallet në tabelat e shpalljeve të Universitetit dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës.

KRYETARI

i Komisionit të zgjedhjeve të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës

Ermir Arifi

